

21916/4

Nv. 1570/2 prot.

AMENDIM Nr.1 I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
(Marrëveshja e Bashkëpunimit me Nr.21916/1 datë 01.06.2017)

E lidhur sot më datë 23/11 /2017 lidhet ky Amendim Nr. 1 i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis palëve dhe me përmbajtje si më poshtë vijon:

GEF, Small Grant Programme, me adresë Rr. "Pjetër Bogdani", Pallati 38/1, Kati 4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Arian Gace**, Menaxher i Programit.


Bashkia Tiranë, me adresë: "Sheshi Skënderbej", nd. 2, kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Erion Veliaj**, Kryetar.

Oendra "Grupimi Ekolëvizja", e regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Nr. 303, datë 20.04.2006, NIPT K62016007S, me adresë: Rruga "Medar Shtylla", Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Xhemal Mato**, Drejtor Ekzekutiv.

Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, e regjistruar si person juridik datë 29.07.1996 me NIPT J61929020T, me funksion sipas vendimit nr. 215, datë 15.07.1991 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, me adresë: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga **Prof. Dr. Andrea Maliqari**, Rector.

MEQËNËSE:

- Në kuadër të bashkëpunimit publik-privat dhe mbështetjes së donatorëve për Bashkinë Tiranë, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, GEF/SGP, "Grupimi Ekolëvizja" kanë lidhur një marrëveshje bashkëpunimi protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me Nr. 21916/1 datë 01.06.2017 për realizimin e Projektit "Tarracat e Gjelbërta" në godinën e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU), Tiranë, sipas standardeve teknike përkatëse të specifikuara nga Bashkia Tiranë me qëllim shtimin e gjelbërimit dhe promovimin e hapësirave të përmirësuara për frymëmarrjen e kryeqytetit (më poshtë referuar edhe si "**Marrëveshja e Bashkëpunimit**").
- Për shkak të problemeve të ndryshme dhe kushteve jo të favorshme klimaterike (temperaturave shumë të ulta), nuk është bërë e mundur realizimi i projektit brenda afatit të përcaktuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi e për rrjedhojë ka lindur nevoja për shtyrje të afatit;



- Neni 8 pika 9.4 e Marrëveshjes së Bashkëpunimit parashikon se “Çdo rregullim ose ndryshim në këtë marrëveshje mund të kryhet vetëm nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve.”

Palët, duke qenë se ekzistojnë kushtet e mësipërme e mbështetur në nenin 690 të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar, bien dakort të hyjnë në këtë Amendim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr. 21916/1 datë. 01.06.2017 si më poshtë vijon:

Neni 1

Neni 4i Marrëveshjes së Bashkëpunimit që ishte: *Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje përcaktohet për një periudhë 6 (gjashtë) mujore, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët. Periudha e punimeve do të konsiderohet e mbyllur 15 ditë pas realizimit të investimit siç është përcaktuar në marrëveshje, periudhë kjo e nevojshme për verifikime, rakordime, rregullime të mangësive apo pasaktësive në zbatim, ndryshon e do të lexojë si më poshtë vijon:*

“Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje përcaktohet për një periudhë 9 (nëntë) mujore, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët. Periudha e punimeve do të konsiderohet e mbyllur 15 ditë pas realizimit të investimit siç është përcaktuar në marrëveshje, periudhë kjo e nevojshme për verifikime, rakordime, rregullime të mangësive apo pasaktësive në zbatim.”

Neni 2

Të gjitha kushtet e tjera për Marrëveshjen e Bashkëpunimit (protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me Nr. 21916/1 datë 01.06.2017) mbeten të pa ndryshuara.

Neni 3

Amendimi Nr. 1 i Marrëveshjes së Bashkëpunimit, është pjesë përbërëse dhe e pandarë e Marrëveshjes së Bashkëpunimit protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me Nr. 21916/1 datë 01.06.2017) të lidhur për objektin “Tarracat e Gjelbërta”.

Ky Amendim Nr.1 hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga Palët:

GEF/SGP

Arian Gace

Menaxher i Programit

QENDRA

GRUPIMI EKOLËVIZJA

Xhemal Mato

Drejtor-Ekzekutiv

BASHKIA TIRANË

Erion Vellaj

Kryetar

UNIVERSITETI POLITEKNIK
I TIRANES

Prof. Dr. Andrea Maligari
Rektor

2017